

RREGULLORE PER CERTIFIKIMIN E ORGANIZMAVE

(CG.PG-03.2)

GJENDJA E DOKUMENTIT

REV.	PAR.	FAQ.	PËRSHKRIM	Data REV.
01			Lëshimi i dokumentit	09/06/2016

KOPJE E KONTROLLUAR N.r

KOPJE JO E KONTROLLUAR N.r

REDAKTUAR	SHIKUAR DHE MIRATUAR
Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme nr.1/bis dt. 19/06/2016	Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme nr.1/bis dt. 19/06/2016

NENI 1 - HYRJE

1.1 Ky dokument përbën Rregulloren e përgjithshme të përshtatur nga CCI SH.P.K. (tani e mbrapa CCI SH.P.K.) për certifikimin e Sistemeve të Administrimit (tani e mbrapa S.A.) , duke respektuar të gjitha normat e referimit. Në veçanti, kjo përcakton kushtet e përgjithshme të kontratës për të gjithë shërbimet e certifikimit të ofruara nga CCI SH.P.K..

Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e kontratës së nënshkruar.

1.2 Kjo Rregullore është e vlefshme dhe për të gjitha certifikimet e shpërndara në mungesë të akreditimit DA.

1.3 Qëllimi i veprimtarisë së certifikimit është ai që të garantojë, në një nivel të lartë besueshmërie, që Organizmi vepron sipas kërkesave të normativave të caktuara të Sistemeve të Administrimit.

NENI 2 - PËRKUFIZIME

Për qëllimin e kësaj Rregulloreje janë të vlefshme përkufizimet që paraqiten më poshtë:

- **Organizëm:** sipërmarrje që ka ndërmarrë procesin e certifikimit me CCI SH.P.K. ose e certifikuar nga CCI SH.P.K.

Kontroll: proces sistematik, i pavarur dhe i dokumentuar, me qëllimin për të verifikuar përputhjen e një Organizmi me standarte të caktuara operative, përmes realizimit të se cilit CCI SH.P.K. garanton që Organizmi vepron në përputhje me modelin e S.A. të dokumentuar , për të cilin kërkohej certifikimi.

- **Audit:** person që ka kompetencën për të kryer një Kontroll.

- **Sistem Administrimi:** sistem administrimi për të drejtuar dhe mbajtur nën kontroll një Organizëm duke respektuar standartet e normës së referimit.

- **Ankesë:** çdo vëzhgim i Organizmit që lidhet me procedurat e vëna në zbatim nga CCI SH.P.K në zhvillimin e aktiviteteve të saj.

- **Rekurs:** çdo kundërshtim nga ana Organizmit për sa i përket përmbajtjes së dokumentacionit, që ka ndikim në dhënien e certifikimit.

- **Organizëm Certifikimi:** organizëm që realizon certifikimin e përputhshmërisë.

- **Certifikim Përputhshmërie:** akt përmes së cilit një organizëm i pavarur deklaron, me besueshmëri të arsyeshme, që një produkt, proces ose shërbim i caktuar është në përputhje me një normë specifike ose me një dokument tjetër përkatës.

NENI 3 – TË DREJTAT DHE DETYRIMET E CCI SH.P.K.

3.1 CCI SH.P.K. impenjohet që të çojë përpara, me zell profesional, një vlerësim përputhshmërie të Sistemit të Administrimit të Organizmit duke respektuar atë që është parashtruar në normat e referimit dhe, në rastin e një përfundimi pozitiv, të lëshojë këtë certifikatë përputhshmërie.

3.2 CCI SH.P.K. nuk ka ndërmend dhe as nuk ka mundësi, të mbajë një përgjegjësi për rezultatin pozitiv të verifikimit të përputhshmërisë e gjithashtu, në lëshimin e certifikatës.

3.3 CCI SH.P.K. garanton kohëzgjatje minimale për verifikimet (të shprehura në mënyrë të përmbledhur në person/ditë), ashtu siç janë përcaktuar nga normat e referimit për akreditimin.

3.4 3.4 Shërbimet që ofrohen nga CCI SH.P.K. do të realizohen nga një personel i përgatitur dhe i kualifikuar, i zgjedhur nga vetë CCI SH.P.K. Të gjithë auditët që CCI SH.P.K. do të përdorë e kontrolleve në Organizmin janë kualifikuar si auditë të Sistemeve të Administrimit duke respektuar procedurat e brendshme të CCI SH.P.K. dhe në bazë të përvojës profesionale të shfaqur në sektorin EA (European Accreditation) objekt i kësaj Rregulloreje. Këto procedura të brendshme përbushin të gjitha kërkesat e normativës ndërkombtare që i aplikohen veprimtarive të certifikimit të Sistemeve të Administrimit.

3.5 CCI SH.P.K. ka të drejtën e ndryshimit të përmbajtjes së procedurave të referimit, meqënëse politika e saj parashikon një kërkim të vazhdueshëm në përmirësimin e shërbimeve të saj.

NENI 4 – TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORGANIZMIT

4.1 Organizmi që kërkon certifikimin, është i detyruar që:

- a) respektojë gjithë çka është përcaktuar në këtë Rregullore;
- b) t'i përcjellë CCI SH.P.K., pa vonesa të paarsyeshme, të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për rendimentin e shërbimit të certifikimit që është objekt i kësaj Rregulloreje;
- c) të garantojë kompletimin dhe vërtetësinë e dokumentave dhe të informacioneve të vëna në dispozicion të auditëve të ngarkuar nga CCI SH.P.K.. Në lidhje me këtë gjë, CCI SH.P.K. është qartësisht e përjashtuar nga çfarëdo përgjegjësie në rastin kur ka mangësi ose mungesa të komunikimit të të dhënave, ashtu si edhe në rastin kur këto të dhëna nuk korrespondojnë me situatën reale të sipërmarrjes;
- d) t'i garantojë CCI SH.P.K. një akses të lirë në të gjitha selitë e Organizmit (ligjore dhe/ose operative dhe/ose lëvizëse) dhe kontaktin me personelin, me qëllim vlerësimin korrekt të S.A nga ana e CCI SH.P.K.;
- e) të pohojë të paturit e një S.A të certifikuar eskuzivisht për veprimtari/njësitet operuese/selitë për të cilat është dhënë certifikimi;
- f) të mos përdorë certifikimin në mënyrë që të shkaktojë përçmim për CCI SH.P.K.;
- g) të përdorë certifikimin vetëm pas dorëzimit efektiv të tij;
- h) të garantojë që asnjë dokument certifikimi dhe as ndonjë pjesë e tij të përdoren në mënyrë të dyshimtë dhe/ose mashtruese;
- i) të mos përdorë certifikimin e dhënë nëse është tërhequr, pezulluar dhe/ose ka skaduar;
- j) t'i komunikojë menjëherë CCI SH.P.K. të gjitha situatat e mundshme të ndryshuara që janë nxjerrë në pah nga Autoritetet e kontrollit, si dhe pezullime ose revokime të mundshme të autorizimeve, konçesioneve, etj, që kanë të bëjnë me produktet, proceset dhe shërbimet që lidhen me certifikimin e marrë;
- k) t'i komunikojë menjëherë CCI SH.P.K. procedura gjyqësore dhe/ose administrative që po zhvillohen, që kanë të bëjnë me fushën e aplikimit të kësaj Rregulloreje, duke ruajtur limitet e vëna nga ligji, dhe të azhurnojë në mënyrë konstante CCI SH.P.K. mbi zhvillimet e këtyre procedurave; në lidhje me këtë pikë dhe me pikën e mëparshme j), CCI SH.P.K. mund të zbatojë verifikime inspektive të jashtëzakonshme të mundshme dhe të shpejta dhe, natyrisht, të ndërmarra masa pezullimi kujdesor dhe/ose revokim të certifikimit të dhënë, duke u bazuar në jo përputhshmërinë reale e verifikuar tek Sistemi i Administrimit i Organizmit;
- l) të informojë në mënyrë të detajuar CCI SH.P.K. përsa i përket çfarëdo rreziku që ekziston në ambientin ku e kanë të orientuar punën e tyre grupet e vlerësimit të CCI SH.P.K.;
- m) të marrë masa, sa herë që CCI SH.P.K. e fillon veprimtarinë e saj në një seli që është objekt i verifikimit, që të ndërmarra masat e duhura të sigurisë, në mënyrë që të garantojë një ambient pune të sigurtë dhe në përputhje me legjisllacionin në fuqi që lidhet me këtë gjë;

n) të shlyejë CCI SH.P.K. për veprimtaritë e kryera, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore; pagesa duhet të kryhet sipas afateve dhe formaliteteve të paraqitura në kontratë dhe/ose në dokumentat që janë të bashkangjitur aty dhe të pranuar nga Organizmi.

4.2 Organizmi, pasi të jetë kryer çertifikimi, ka të drejtën të publikojë këtë gjë në mënyrat më të përshtatshme, mjafton që t'i referohet në mënyrë korrekte objektit dhe limiteve të çertifikimit të kryer, ashtu siç paraqiten në procedurën referuese.

4.3 Në vazhdimësi të dhënies së çertifikimit, Organizmi duhet t'i përmbahet strukturës së vet në përputhje me kushtet e kërkuara nga normat dhe të përcaktuara në çertifikatë, përgjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së çertifikimit.

4.4 Nëse ka ndërmend të ndryshojë pjesë të rëndësishme të pronësisë dhe/ose rregullin e shoqërisë (p.sh. ndryshim i të dhënave në kërkesën e çertifikimit, ndërprerje të aktivitetit, etj), me qëllim përputhshmërinë me normat e referimit, Organizmi duhet t'i dorëzojë CCI SH.P.K. një komunikatë preventive me shkrim, e cila mund të pranojë ndryshimet ose të parapregatisë kryerjen e verifikimeve shtesë.

4.5 Në rastin kur Organizmi i çertifikuar ka ndërmend të ndryshojë fushën e vlefshmërisë të çertifikimit (qëllimin e çertifikimit), duhet t'i bëjë një kërkesë me shkrim CCI SH.P.K., e cila do të vendosë nëse do jetë i nevojshëm ose jo një kontroll e ri dokumentues dhe/ose inspektues.

NENI 5 – PROCEDURA E ÇERTIFIKIMIT

- Të shihen procedurat specifike tek “Realizimi i Shërbimit të Çertifikimit” duke iu referuar normativave në fjalë të cilat bashkangjitur me këtë dokument, me Kërkesën e Ofertës dhe me ofertë – kontratën tonë, janë pjesë përbërëse e kontratës.

NENI 6 – KUSHTET EKONOMIKE

6.1 Ofertë-kontrata është redaktuar mbi bazën e të dhënave të sjella nga Organizmi përmes përpilimit të kërkesës së ofertës. Në rastin kur këto informacione rezultojnë jo të vërteta, CCI SH.P.K. mund të vendosë ta kthejë të pavlefshme këtë ofertë-kontratë ose të riformulojë, mbi bazën e informacioneve reale, vleftat e detyruara të Organizmit.

6.2. Në rastin kur Organizmi nuk pranon ndryshimin e vlerës së kërkuar nga CCI SH.P.K. si pasojë e verifikimit që është parashikuar në pikën 6.1., CCI SH.P.K. mund të refuzojë kryerjen e paraqitjes së shërbimit të kërkuar dhe Organizmi mbetet i detyruar të paguajë të gjitha shpenzimet e bëra nga CCI SH.P.K. deri në atë moment.

6.3 Organizmi impenjohet të sinjalizojë, përpara kryerjes së Kontrolleve të Çertifikimit, çfarëdo lloj ndryshimi që lidhet me të dhënat e sjella tek Kërkesa e Ofertës (numri i punonjësve, numri i kantierëve të hapura dhe llojeve të veprimtarisë, selitë operative lëvizëse), meqënëse këto ndryshime mund të ndikojnë tek kohëzgjatja e Kontrolleve dhe tek formalitetet e planifikimit.

6.4 Realizimi i një shërbimi të ndryshëm nga ata që janë parashikuar tek ofertë –kontrata, do të llogaritet sipas tarifave në fuqi të CCI SH.P.K. në momentin e kryerjes.

6.5 CCI SH.P.K. ruan të drejtën të rishikojë honoraret përgjatë dhe në fund të realizimit të shërbimit, në funksion të variacioneve të treguesit ISTAT, përveç rastit të nënshkrimit të kushteve, duke aplikuar formulën e mëposhtme:

$$A = B \quad \text{-----}$$

Ig

- ku: B = çmimi i caktuar nga firmosja e kontratës;
Ig = treguesi i përgjithshëm i pagesës në orë me kontratë,
i publikuar nga ISTAT dhe që i referohet momentit të firmosjes së kontratës;
I = vlera e vetë treguesit në momentin e revizionit;
A = çmimi i ri;

Në këtë rast Organizmi do të informohet paraprakisht me shkrim mbi synimin e CCI SH.P.K. për aplikimin e formulës së revizionimit dhe nëse është dakort, duhet të deklarojë pranimin e tarifës së re, me shkrim, brenda 30 ditëve nga marrja e komunikatës së bërë nga CCI SH.P.K..

6.6 Në rastin kur mund të jenë të nevojshme Kontrollë të jashtëzakonshme, të drejtuar në kontrollimin e efikasitetit të veprimeve korigjuese të zbatuara si rrjedhojë e jo përputhshmërive të hasura gjatë zhvillimit të procesit fillestar të çertifikimit, këto do të llogariten duke aplikuar tarifën në fuqi të audit/ditë e paraqitur tek ofertë/kontrata.

6.7 Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe ndenjes do të llogariten me çmimin dhe/ose afrofe ashtu siç është parashikuar në pikën 2 të ofertë-kontratës (Kushtet kontraktuese: oferta ekonomike edhe afatet e kontrolleve – Kostot e trasfertës).

6.8 Pagesat do të llogariten si më poshtë:

- 40% i shumës totale do të llogaritet në momentin e pranimit të ofertë-kontratës, si *“Fillim i veprimtarisë dhe Programimit të tyre”*.
- 60 % i mbetur i shumës, plus shuma që lidhet me rimbursimin e shpenzimeve, do të llogariten në fund të kontrollit fillestar të çertifikimit të fazës 2 ose të fazës në seli.

6.8.1 PAGESA kryhet pavarësisht lëshimit të çertifikatës së miratimit dhe fatura duhet të paguhet sapo të merret, pavarësisht nga rezultati pozitiv dhe/ose negativ i Kontrollit dhe gjithsesi përpara dhënies së çertifikatës.

6.8.2 Për çfarëdo forme tjetër shlyerje pagese duhet të bihet dakort dhe të pranohet nga të dy palët në momentin e pranimit të ofertë/kontratës.

6.8.3 Në secilin prej rasteve, lëshimi dhe dhënia e Çertifikimit të Miratimit do të kryhen vetëm kur të jenë shlyer të gjitha llogaritë e lëshuara.

6.9 Të gjithë honorareve u shtohet T.V.SH me 20% aty ku është e detyrueshme.

6.10 Pagesat duhet të kryhen me faturë përmes një urdhërshirim bankar ose çek.

6.10.1 Në rastin kur një pagesë nuk është kryer, CCI SH.P.K. mund të aplikojë pa paralajmërim interesat e kamatvonesës me taksën zyrtare të skontos, i pjekur me 5 pikë në përqindje.

6.10.2 Kërkesa e shtyrjes së kontrollit, e dërguar pas dhjetë ditëve pune përtej datave që i janë komunikuar Organizmit, bën që të zbatohet pagesa e një gjobe e barazvlefshme me 50% të kostos së ditëve/njerëz të planifikuara.

NENI 7 – VLEFSHMËRIA E ÇERTIFIKATËS

7.1 Çdo çertifikatë e lëshuar ka një kohëzgjatje 3 (tre) vjeçare, duke nisur nga data e lëshimit të parë ose rinovimi i saj (në secilin rast, data e skadimit është përcaktuar qartësisht në çertifikatë).

7.2 Organizmi që zotëron një çertifikim duhet të informojë menjëherë me shkrim CCI SH.P.K. për çdo ndryshim që zbatohet në Sitemin e tij me anë të një dokumentacioni të përshtatshëm. Këto ndryshime, nëse CCI SH.P.K. e quan të arsyeshme, mund të motivojnë një vizitë tjetër vlerësimi, që do kryhet në ngarkim të Organizmit të çertifikuar.

7.3 Efikasiteti i çertifikatës i nënshtrohet zbatimit të rregullt të Kontrolleve vjetore.

7.4 Në përfundim të çdo trevjeçari, në rast se Organizimi nuk ka dërguar komunikatën e tërheqjes së kontratës, sipas formaliteteve të përcaktuara nga kjo Rregullore tek neni 9, nuk ka dërguar deklaratën e tërheqjes nga kontrata, do të procedohet me një ritestim komplet të sistemit. Në rastin kur rezultati i këtij rikontrollit është pozitiv, do të procedohet me dhënien e një çertifikate të re e vlefshme për tre vitet e ardhshme.

NENI 8 - EFIKASITETI I KONTRATËS

Kontrata e nënshkruar me CCI SH.P.K. e detyron Organizimin nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri në datën e skadencës së çertifikatës si objekt i kontratës së firmosur dhe/ose të rinovimeve të mëpasshme.

NENI 9 - TËRHEQJE

9.1 Secila nga palët mund të tërhiqet nga kontrata në rastet si më poshtë vijojnë dhe me këto formalitete:

- a) kur skadon çertifikata, përmes dërgimit të një Rekomandimi A/R, 3 muaj përpara datës së skadencës së kontratës;
- b) pasi njëra nga palët t'i ketë komunikuar palës tjetër një shkelje materiale të kontratës;
- c) në rastin kur njëra nga palët i nënshtrohet një procedurë falimentimi dhe/ose nuk respekton detyrimet ekonomike (shuma, pagesë etj) të parashikuara tek ofertë/kontrata e pranuar.
- d) në rastin kur Organizimi ndalon veprimtarinë që është objekt i çertifikimit; në këtë rast, gjithsesi, ky fakt duhet të jetë i dokumentuar me evidenca të vërteta;
- e) në rastin kur kemi një mospranim të ndryshimeve të llojit ekonomik të kontratës në vijim, përveç rastit kur këto ndryshime janë të justifikuara nga ndryshime thelbësore të Organizimit;
- f) në rastin kur kemi një mospranim të revizionimeve thelbësore të kësaj Rregulloreje ose të procedurave ose të Normave dhe/ose të Kushteve, (të cilave CCI SH.P.K. ka ndërmend t'u japë vlerë prapavepruese);, duke përjashtuar, në këtë rast, revizionime të mundshme të përcaktuara nga normat e referimit dhe nga Enti i akreditimit të cilëve CCI SH.P.K., dhe si rrjedhojë organizmat e çertifikuar, ju nënshtrohen.

9.2 Në rastin kur Organizimi mund të vendosë të tërhiqet nga kontrata e nënshkruar brenda 30 ditëve nga data e këtij nënshkrimi dhe përpara nisjes së çfarëdo veprimtarie, do t'i depozitojë CCI SH.P.K., në cilësinë e klauzolës penale, 40% të shumës së parashikuar për kryerjen e "proçesit fillestar të çertifikimit".

9.3 Në rastin kur janë ndërmarrë veprimtari nga ana e CCI SH.P.K., përveç penaltetit në pikën 9.2, Organizimi duhet t'i rimbursojë CCI SH.P.K. kostot e punës së zhvilluar (kosto të llogaritura mbi bazën e kohës së harxhuar për kryerjen e veprimtarisë specifike që do të faturohen me vlerën €1.250,00 plus tvsh per një ditë/njeri me një faturim minimal prej €600,00+tvsh).

9.4 Në rastit kur Organizimi mund të vendosë të tërhiqet nga kontrata e nënshkruar, pas dhënies së çertifikatës apo rilëshimit si rrjedhojë e rinovimit, por përpara përfundimit të trevjeçarit, për arsye të ndryshme nga ata që janë renditur në pikën 9.1, do t'i derdhë CCI SH.P.K. një shumë që s'mund të jetë më pak sesa 70% i asaj që është parashikuar në kontratë për të gjithë trevjeçarin; ky 70% do të llogaritet mbi shumat ende të pafaturuara.

NENI 10 – PËRDORIMI I LOGOTIPIT TË ÇERTIFIKIMIT

Për përdorimin e logos do të shihet Udhëzuesi i Brendshëm specifik i cili do t'i dorëzohet, së bashku me logotipin e çertifikimit, të gjithë Organizimave që do të kryejnë një çertifikim nga CCI SH.P.K..

10.1 Logoja është mjeti i identifikimit grafik të dokumentacionit zyrtar dhe të korrespondencës së lëshuar nga CCI SH.P.K. dhe është pronë ekskluzivisht i saj.

10.2 Logoja që Organizmat mund të përdorin është ajo që do t'i dorëzohet në momentin e dhënies së Çertifikimit.

10.3 Organizmi mund ta përdorë logon vetëm në atë mënyrë që është autorizuar me shkrim nga CCI SH.P.K.. Gjithashtu Organizmat janë të detyruara t'i deklarojnë CCI SH.P.K. ndryshimet në përdorimin e logos, dhe në këtë mënyrë të marrë një autorizim me shkrim nga CCI SH.P.K..

NENI 11 – PEZULLIMI DHE TËRHEQJA E ÇERTIFIKIMIT

11.1 Vlefshmëria e Çertifikimit mund të ndërpritet nga CCI SH.P.K. si masë mbrojtëse, si dhe në të gjitha rastet në të cilat, pas një analizë të hollësishme, ajo vlerëson që Sistemi i Administrimit të Organizmit nuk i përgjigjet më kushteve të normës dhe/ose rregullave të çertifikimit. Ndërprerja mund të kërkohet edhe nga vetë Organizmi.

11.1.1 Ndërprerja është e parashikuar në rastet e mëposhtme:

a) shfaqja e jo përputhshmërive, të pazgjidhura nga Organizmi në afatet e caktuara nga CCI SH.P.K. dhe/ose kur nuk janë marrë masa për veprime korigjuese brenda kohës së caktuar;

b) kur kemi jopërshtatje, brenda afateve të caktuara, nga ana e Organizmit, të vetë Sistemit të tij me ndryshimet e normës dhe/ose rregullave të çertifikimit, të komunikuara nga CCI SH.P.K.;

c) mungesë e gadishmërisë nga ana e Organizmit për kryerjen e kontrolleve të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm;

d) mungesë e gadishmërisë nga ana e Organizmit për kryerjen e kontrolleve në prani të Vlerësues/vëzhguesve të SINCERT;

e) mungesë pranueshmërie të kontrolleve suplementare të kërkuara nga CCI SH.P.K., edhe pse janë të motivuar;

f) mungesë komunikimi tek CCI SH.P.K. të ndryshimeve të bëra në Sistemin e tij;

g) mungesë informimi tek CCI SH.P.K. rreth procedimeve gjuhësore dhe/ose administrative;

h) në rastin e dënimit të Organizmit për fakte që kanë si subjekt mungesën e respektit ndaj kërkesave që lidhen me Sistemin që është subjekt i çertifikimit;

i) administrim i mangët i ankesave dhe/ose sinjalizimeve që lidhen direkt me mangësitë e Sistemit të çertifikuar;

j) mosderdhje e shumave që i detyrohen CCI SH.P.K. sipas kushteve të përcaktuara në kontratë;

k) përdorim i logos sipas mënyrave jo të përputhshme me atë që është përcaktuar në këtë Rregullore në nenin 10.

11.1.2 Ndërprerja e çertifikimit gjithashtu mund të vendoset edhe nga CCI SH.P.K. në rastin e një përdorimi jo korrekt të çertifikatës, gjithnjë nëse nuk bëhet fjalë për një parregullsi aq të rëndë sa të çojë në një procedim të pezullimit të çertifikimit. Në veçanti, përdorimi i çertifikatës është i parregullt:

a) kur Organizmi e përdor çertifikatën në mënyrë të tillë që të tregohet përçmim ndaj CCI SH.P.K.;

b) kur Organizmi bën deklarata mashtruese dhe/ose të pautorizuara, që lidhen me çertifikimin e tij.

11.1.3 Gjatë periudhës së pezullimit të çertifikimit të tij, Organizmi nuk mund ta përdorë çertifikatën dhe as të kualifikohet si Organizëm i çertifikuar dhe duhet të njoftojë palën e tretë të interesuar, me mënyra të përshtatshme, për kushtet e pezullimit të çertifikimit të tij, në të

gjitha rastet kur kjo çertifikatë është vendimtare në qëllimin e arritjes së një blerjeje apo mbajtjes së një kontrate dhe/ose të një furnizimi.

11.1.4 Periudha e pezullimit të çertifikimit përcaktohet nga CCI SH.P.K. dhe kjo masë mund të ndërpritet vetëm pasi Organizmi të ketë treguar se i ka eliminuar shkaqet që e kanë shkaktuar. Gjatë kësaj periudhe Organizmi nuk mund të çertifikohet nga një Organizëm tjetër çertifikimi dhe gjithashtu është e detyruar të derdhë të detyrimet vjetore të mirëmbajtjes siç janë përcaktuar në kontratë.

11.2 CCI SH.P.K. rezervon të drejtën e tërheqjes së çertifikimit nëse Sistemi i Administrimit nuk garanton që respekton kushtet minimale të normës së referimit dhe të Rregullores së çertifikimit dhe nëse CCI SH.P.K. vlerëson që Organizmi nuk është në gjendje të sistemojë jopërputhshmërinë në këtë rast.

11.2.1 Në veçanti, çertifikimi mund të tërhiqet në rastet si më poshtë:

- a) në mungesë të eliminimit të shkaqeve që kanë çuar në pezullimin e çertifikimit për një periudhe që është caktuar nga CCI SH.P.K.;
- b) ndalim i aktivitetit të Organizmit që është subjekt i çertifikimit ose ndalim i tij për një periudhë më shumë se 6 muaj;
- c) parregullsi të mëdha në përdorimin e çertifikatës dhe/ose logos së çertifikimit;
- d) kalimi në të pandehur në një dënim përfundimtar të Organizmit për fakte që lidhen me mungesën e respektit ndaj kushteve të nevojshme të Sistemit të Administrimit subjekt i çertifikimit;
- e) mungesë e derdhjes së shumave të detyrueshme, nëse Organizmi vazhdon në mospërbushjen e tij, pavarësisht dërgimit të një paralajmërimi me fax ose rekomande;
- f) mosrespektime të vazhdueshme të detyrimeve të marra përsipër, edhe pse në mënyrë jo të rëndë;
- g) sjellje jokorrekte nga ana e Organizmit i cili, me pakorrektesi të shfaqura ndaj klientëve të tij, vë në diskutim prestigjin e CCI SH.P.K.

11.2.2 Në rastin e një tërheqje të çertifikimit, ashtu si në rastin e tërheqjes tek neni 9, Organizmi duhet:

- a) të kthejë dokumentat origjinale të çertifikimit që posedon, përfshirë edhe çertifikatën e miratimit;
- b) të mos përdorë kopje të mundshme ose riprodhime të çertifikimit;
- c) të mos përdorë të gjithë dokumentacionin teknik dhe/ose publicitar, që përfshin logon dhe/ose referime të çertifikimit të lëshuar nga CCI SH.P.K dhe të shkatërrojë të gjithin;
- d) të ndalojë menjëherë çdo referim të mundshëm të çertifikimit të tërhequr;
- e) t'ia sinjalizojë porositësve të tij statusin e tërheqjes.

11.2.3 CCI SH.P.K do të marrë masa që të sinjalizojë për tërheqjen e bërë, me anë të publikimeve të përshtatshme. CCI SH.P.K mund të vendosë që të rifillohet procesi i çertifikimit, në rastin kur Organizmi arrin të demostrojë që ndërkohë ka marrë të gjitha masat e nevojshme, të vëna në zbatim për të evituar përsëritjen e moskorrektësive që kishin shkaktuar tërheqjen.

11.2.4 Revokimi dhe tërheqja kontraktuale pra neni 9, nuk i japin Organizmit të drejtën e asnjë rimbursimi, por e detyrojnë Organizmin të paguajë të gjithë shumat e mundshme që CCI SH.P.K ka për të patur për verifikimin që Organizmi që këtë përbushur duke respektuar atë që është përcaktuar më sipër.

NENI 2 – KUSHTET THEMELORE

12.1 Organizmi, duke pranuar ofertë-kontratën dhe pasi të ketë kaluar pozitivisht kontrollin e çertifikimit, garanton dhe impenjohet ndaj CCI SH.P.K, gjatë periudhës së vlefshmërisë së çertifikimit, që respekton të gjithë kërkesat e nevojshme për lëshimin dhe mirëmbajtjen e

çertifikatës së mirëmbajtjes, përfshirë edhe normat, rregullat, kodet, normativat dhe të tilla të ngjashme të lëshuara nga Autoritete kompetente, që kanë të bëjnë me çertifikimin që ai zotëron.

12.2 – Në rastin kur kryhen ndryshime thelbësore që kanë të bëjnë me karakteristikat e klientëve, të cilat lidhen me rregulloren e skemës së çertifikimit, CCI SH.P.K do të paraqesë tek faqja e saj www.cdigitalia.it ndryshimet e ndodhura dhe kushtet e aplikimit të tyre. Në këtë rast CCI SH.P.K do të marrë masa në vlerësimin e vëzhgimeve të mundshme të bëra nga palët e interesuara.

12.2.1 Organizmi, pasi të ketë shikuar ndryshimet, duhet t'u përshtatet atyre; në rastin kur nuk ka ndërmend të veprorë në përputhje me to, mund të tërhiqet nga kontrata, përveç rastit kur ndryshimet e bëra nga CCI SH.P.K të jenë të detyruara nga normat e referimit dhe enti i akreditimit, të cilit vetë ajo e si rrjedhojë organizmat e çertifikuara, i nënshtrohen. Tërheqja bëhet me anë të dërgimit, nga ana e Organizmit, të një komunikate me shkrim rreth vendimit të tij drejtuar C CCI SH.P.K përmes një rekomandimi A/R, brenda dhe jo më shumë se 30 ditëve; pasi të ketë kaluar ky fakt, ndryshimet e reja nënkuptohen të pranuar.

NENI 13 – PËRGJEGJËSITË CIVILE

13.1 Duke bërë përjashtim në rastet kur është e dukshme dhe e shfaqur qartë një sjellje neglizhente nga ana e CCI SH.P.K., e punonjësve dhe/ose bashkëpunëtorëve të saj, ajo nuk është përgjegjëse për asnjë humbje apo dëm të pësuar nga gjithkush dhe si pasojë e një veprimi jokorrekt dhe/ose gabimi të çfarëdoshëm, që janë shkatuar në ndonjë mënyrë gjatë zhvillimit të Kontrollit të çertifikimit ose gjatë zhvillimit të shërbimeve të tjera.

13.2 Në rastin e një neglizhimi të vërtetuar, çfarëdolloj humbjeje ose dëmi për të cilat CCI SH.P.K rezulton përgjegjëse do të kufizohet në një shumë jo më lartë se tarifat e CCI SH.P.K që lidhen me shërbimin për të cilin rezulton neglizhent.

13.3 Lëshimi dhe mirëmbajtja e çertifikimit të Sistemit të Administrimit nuk përbën për CCI SH.P.K., garanci në lidhje me pjesën e Organizmit të çertifikuar për detyrimet e Ligjit dhe të kërkesave që lidhen me të, të cilave ajo është e detyruar t'u përmbahet. Organizmi është përgjegjës, si ndaj vetes, ashtu edhe ndaj palës së tretë, për një zhvillim korrekt të veprimtarive të tij dhe të përputhshmërive të këtyre veprimtarive si dhe/ose produkt/shërbimeve të realizuara me normativat e aplikueshme dhe me pritshmëritë e klientëve dhe të tretëve në përgjithësi.

NENI 14 – DËMSPËRBLIMET

Organizmi është i detyruar t'ia paguaj CCI SH.P.K dëmshpërblimin e plotë për të gjitha ankesat, veprimet dhe dëmet, që janë pasojë:

- a) e përdorimit të gabuar dhe/ose abuzimit nga ana e Organizmit të çertifikatës së lëshuar nga CCI SH.P.K;
- b) e çdo mospërmbushjeje të kontratës;
- c) e prishjes së imazhit të CCI SH.P.K;
- d) e përdorimit të rremë dhe/ose në formë mashtrimi të çertifikimit në lidhje me të tretët.
- e) e përdorimit të gabuar të logotipit të çertifikimit.

NENI 15 – SHKAQE MADHORE

CCI SH.P.K nuk është përgjegjëse për detyrimet e përcaktuara në kontratë, nëse nuk ka për të qene në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për shkaqe të rrethanave logjike të paparashikuara dhe që nuk varen nga vullneti i saj.

NENI 16 – PRIVACY

16.1 Organizmi dhe CDQ i quajnë krejtësisht konfidenciale të gjithë dokumentat dhe/ose informacionet që janë nën kujdesin e tyre apo të punonjësve, bashkëpunëtorëve ose të tjerëve.

16.2 Organizmi impenjohet që t'i përcjellë informacione të tretëve vetëm nëse është i uautorizuar paraprakisht me shkrim nga ana e CCI SH.P.K, përveç rasteve kur këto informacione janë të kërkuara nga organet ligjore , si Policia, Karabinierët, Policia Financiare dhe/ose nga Gjykata.

Për informacione të mëtejshme që lidhen me trajtimin e të dhënave Tuaja personale, ju lutemi të shikoni Informuesen në përputhje me Nenin. 13 të Dlgs nr. 196/2003 e cila Ju është dërguar e bashkangjitur me Ofertë – Kontratën tonë.

NENI 17 –ANKESA DHE REKURSE

Të shihet dokumenti që i referohet normativave specifike mbi “Rendimentin e Shërbimit të Çertifikimit” i cili bashkangjitur me këtë Rregullore, me Kërkesën e Ofertës dhe me ofertë – kontratën tonë, janë pjesë përbërëse e kontratës.

17.1 Organizmi që do çertifikohet, në lidhje me çfarëdo lloj fakti që është i lidhur me procedurën e çertifikimit që ai e vlerëson si dëm të interesave të tij, mund të paraqesë ankesë pranë CDQ, me shkrim, duke motivuar arsyet.

17.1.1 Ankesa do të shqyrtohet dhe do të vendoset nga Drejtoria e CCI SH.P.K., me qëllim që për këtë vendim, të mund të përcaktojë, nëse janë të nevojshme, shqyrtime të mëtejshme.

17.1.2 Shpenzimet që lidhen me ankesën i ngarkohen Organizmit që e bën, përveç rastit kur ankesa pranohet.

17.2 Në rastin kur Organizmi i quan të paarsyeshme masat që ndjek CCI SH.P.K., brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit që ai ka ndërmend të kundërshtojë, ai mund të prezantojë një rekurs, duke motivuar arsyet, me qëllim që të marrë kthimin e vendimit ose ndryshimin e masës.

17.2.1 Rekursi do të analizohet nga Përfaqësuesi Ligjor i CCI SH.P.K., i cili për këtë vendim, do të vendosë nëse janë të nevojshme shqyrtime të mëtejshme.

17.2.2 Shpenzimet që lidhen me rekursin i ngarkohen Organizmit që e bën, përveç rastit kur rekursi pranohet.

17.2.3 Në rastin e pranimit të rekursit, CCI SH.P.K. do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar eliminimin e shkaqeve të tij.

NENI 18 - ASPEKTI LIGJOR

Për të gjithë mosmarrveshjet që lidhen me interpretimin dhe/ose ekzekutimin e kontratës, të cilat nuk kanë lidhje me kompetencat e Drejtorisë (në funksionin e Përfaqësuesit Ligjor) të CCI SH.P.K., ashtu siç është paraqitur në procedurën referuese, palët zgjedhin si gjykatë kompetente Gjykatën e Tiranës, duke heq dorë shprehimisht nga gjykata e vet dhe duke filluar nga e para ashtu siç është përcaktuar nga codi civil.